



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2019:188632
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05545439

C.nr.192/09

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE-DEGA E GJYKATËS LIPJAN –
Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Avdirrahman Gashi, në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit H. Z. nga L. të cilin e përfaqëson Naser Gashi av. nga Lipjani, kundër të paditurit B. Sh., H. Sh., N. Sh., E. Sh., A. Sh. që të gjithë nga fsh. R. K. L., për shkak të vërtetimi të pronësisë, me datë 04.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake në lëndën kontestimore C.nr..... Si rezultat i ndërprerjes së gjykimit ndërpriten afatet për zhvillimin e veprimeve procedurale.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdon pasi të përfundon procedura në formë të prerë tek çështja paraprake, apo kur gjykata konstaton se nuk ekzistojnë arsyet për të pritur përfundimin e saj.

A r s y e t i m

Paditësi H. Z. nga L. përmes të autorizuarit tek kjo gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurve B. Sh. etj., për vërtetimin e pronësisë.

Gjatë zhvillimit të procedurës i autorizuari i paditësit e ka njoftuar gjykatën se në këtë gjykatë është duke u zhvilluar procedura kontestimore C.nr.... ndërmjet palëve të njëjta ku nga zgjidhja e kësaj çështje do të varet edhe zgjidhja e çështjes kontestuse dhe pa u përfunduar ajo procedurë nuk mund të përfundohet çështja kontestuse për shkak se është e lidhur me të njëjtën lëndë sa i përket çështjeve të parcelave dhe rregullimit të tyre.

Me dispozitën e nenit 278.1 pika a) të LPK-së parashifet se “Përveç rasteve të parashikuara me këtë ligj gjykata e ndërpret gjykimin po që se ka vendosur që vetë të mos e zgjidhë çështjen paraprake”.

Meqenëse procedura ku është duke u zhvilluar kontesti dhe zgjidhja e saj varet nga zgjidhja e çështjes paraprake pra tek lënda C.nr.... për këtë arsye gjykata e aprovoj propozimin e palës paditëse dhe në pajtim me dispozitën e lartë përmendur e ndërprejti procedurën.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr.192/09 dt.04.04.2024

G j y q t a r i
Avdirrahman Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: NumriLëndës
Datë: DataDokumentit
Numri i dokumentit: NumriDokumentit